

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sa mund të dënohet Xhaka nëse del fajtor për falsifikimin e certifikatës së COVID-it?
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/sa-mund-te-denohet-xhaka-nese-del-fajtor-per-falsifikimin-e-certifikates-se-covid-it
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 01:47:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 15:09:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e34809665720447918aa0d84ae85ac924a783494a399cd77fe4596ee5a42cfc5
TEKSTI	0224254f8752595fd18c4316f25c6dcd9af742fc2758bd6a64a0539fb0d0e417
PAMJA	de6dad937dc8d655beb74d67f3d20b250c09bf205f701088bca1ab3ccc5cf0c3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b0f7fad33d0651f56e2b7e265bd421433226ba843858ee3b95e10cb2da34f854
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	1e2948ee29ab13edbd442d93c043487a99670263e579192fb4ff737734c16e45
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b0f7fad33d0651f56e2b7e265bd421433226ba843858ee3b95e10cb2da34f854>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

FUTBOLL

Sa mund të dënohet Xhaka nëse del fajtor për falsifikimin e certifikatës së COVID-it?



19 shtator 2026 17:09

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalim tonë zyrtar në Viber

(Blick) – Në pranverën e vitit 2020, koronavirusi arriti edhe te futbollistët profesionistë. Dy vjet më vonë, pas dy testeve pozitive, kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka, u vaksinua. Ose të paktën kështu pretendohet, pasi Prokuroria ka nisur hetimet. Mediumi zviceran “Blick” të shtunën ka shfaqur kronologjikisht gjithë ngjarjen se për çfarë bëhet fjalë.

Mars 2020 – Sezoni ndërpritet

Pandemia kishte ndikim në futboll. Premier League u ndërpre për shkak të COVID-19. Më 7 mars, Arsenali luajti ndaj West Hamit (1:0), ndërsa Xhaka e komplettoi ndeshjen. “Topçinjtë” ishin në mesin e tabelës. Sezoni më pas përfundoi në verë, ndërsa Arsenali përfundoi i teti.

Vera 2020: Shtyhet Kampionati Evropian

Përfaqësuesja e Zvicrës dhe ylli Granit Xhaka duhej që të luanin në Kampionatin Evropian në atë verë. Megjithatë, turneu u shty për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Edhe



Futboll • 18 sht 2026

Xhaka nën hetime, dyshohet për falsifikimin e certifikatës së COVID-it

Vera 2021: Zhvillohet Evropiani

Pavarësisht rritjes së shkallës së infektimit dhe përhapjes së variantit Delta, “Euro 2020” u mbajt në verën e vitit 2021. Në atë kohë, kërkesa kishte për karantinim dhe testime për udhëtime në ndeshje, në shtete të ndryshme në Evropë. Për Zvicrën, turneu përfundoi në çerekfinalen me Spanjën, pas ekzekutimit të penalltive. Xhaka nuk luajti në ndeshjen e fazës nokaut për shkak të suspendimit.

Gusht 2021: Përfaqësuesja e ndërpret kampanjën e vaksinimit

Showbiz.

“Animals” e rikthen yllin Ben Affleck si regjisor

Futboll.

Rrahmani zëvendësues, Lazio mposht Veneziën

Futboll.

Raphinha i pandalshëm, Barça fiton 3:1 ndaj Sevilas

Shtojca për Kulturë.

Kur pikëllimi shndërrohet në krenari

Arbëri.

Kurti: Nevojitet strategji shtetërore për reagim ndaj verdiktit të Speciales

Basketboll.

Bora e nis edicionin e ri me fitore të thellë

Për të arritur të të rinjtë dhe tek emigrantet nepermjet kampanjes së vaksinimit, Zyra Federale e Shëndetit Publik, dëshiron të bashkëpunojë me përfaqësuesen e Zvicrës. Megjithatë, kampanja e përbashkët me Xhakën, Sommerin dhe të tjerët, nuk u realizua. Shpjegim dha Federata e Futbollit e Zvicrës. “Kampanjat me Përfaqësuesen janë të rezervuara ekskluzivisht me partnerët tanë të sponsorizimit”.

Shtatori i hershëm 2021: Xhaka del pozitiv

Granit Xhaka doli pozitiv në testin për koronavirus më 1 shtator, gjatë kampit stërvitor të Zvicrës në Bazel. Kishte simptoma të lehta, por duhej të karantinohej. Xhaka mungoi në miqësoren ndaj Greqisë dhe në kualifikimet për Botëror.

Përpjekje për vaksinim të detyrueshëm në Premier League

Edhe



Botërori 2026 • 11 kor 2026

BBC me shkrim të gjatë për Xhakën, që u fye tek Arsenali por ringjalli karrierën

Premier League planifikoi vaksinim të detyrueshëm më 1 tetor, 2021. Megjithatë, kishte shumë skepticizëm në mesin e lojtarëve, pse ky plan nuk po zbatohet në vazhdueshmëri.

Janar 2022: Xhaka sërisht pozitiv me koronavirus

Duhej të luante për Arsenalin në Kupën FA kundër Nottingham Forestit, por Granit Xhaka u desh të qëndronte sërisht jashtë fushës më 9 janar. Ai doli pozitiv me COVID-19 për herën e dytë.

Sipas dokumenteve, Xhaka mund të vaksinohet

Dy javë pas doli pozitiv, Granit Xhaka u vaksinua më 25 janar. Të paktën kështu tregon dokumenti i mjekut. Në mars, Xhaka kishte deklaruar për “20 Minuten” në një intervistë: Po, jam vaksinuar dhe nuk kenë çfarë të shkruani më”. Xhaka u vaksinua për herën e dytë më 11 nëntor, 2022.

Policia bastis zyrën e mjekut

Një vit më pas, një bastisje ndodhi në zyrën e mjekut, i cili ishte përkujdesur për vaksinimin e Granit Xhakës kundër COVID-19. Pati disa raportime të disa pacientëve që dyshohej se kanë marrë certifikata të falsifikuara të vaksinimit.

Edhe



Botërori 2026 • 8 kor 2026

Xhaka shpërthen në lot pasi e udhëhoqi Zvicrën drejt historisë

Tani, afro tre vjet më vonë, një tjetër kaptinë e pandemisë së koronavirusit është përfshirë në tregimin e kapitenit të përfaqësueses zvicerane. Siç raporton “Blick”, 33-vjeçari është nën hetime. Xhaka mund të merret në pyetje në fillim të tetorit.

Mediumi “Bluewin” ka shkruar se nëse Xhaka del fajtor për këtë rast, do të marrë vetëm dënim me gjobë.

#GRANIT XHAKA

#PËRFAQËSUESJA E ZVICRËS

Artikuj të ngjashëm



Botërori 2026 • 8 kor 2026

Xhaka duhej ta gjuante penalltinë e tretë, por pse vendosi për të parën?



Botërori 2026 • 19 qer 2026

“Më dhemb” – Xhaka i prekur nga akuzat kundër tij



Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.